



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT PËR VITIN 2025

Prishtinë, maj 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Kryeministrit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Kryeministrit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Pasuritë kapitale në vlerë 465,768€, të blera gjatë vitit 2025 nuk ishin regjistruar në regjistrat përkatës (ishin nëvlerësuar), ndërsa pasuritë jo kapitale (nën 1000EUR) në vlerë prej 6,752€, ishin regjistruar edhe në SIMFK (mbivlerësuar).
- B2 Shpenzimet në vlerë 21,852€, ishin regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ZKM kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Sekretari i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Kryeministrit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Zyrës së Kryeministrit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Zyrës së Kryeministrit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Zyrës së Kryeministrit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Zyrës së Kryeministrit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me katër rekomandime të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mos-regjistrimi dhe regjistrimi jo i duhur i pasurive në sistemet përkatëse

Gjetja

Rregullorja e MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6 Regjistri i pasurive jo financiare paragrafi 3, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria"

Nga vlerësimi i regjistrave të pasurive kemi identifikuar se pasuritë kapitale të ZKM-së ishin nënvlerësuar për 465,578€, ndërsa ishin mbivlerësuar për 6,752€. Informatat në detaje shihni në vijim:

- Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2025, kishte blerë software në vlerë prej 461,920€, i cili nuk ishte regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale në sistemin SIMFK.
- Instituti i Kosovës për Krime Luftë nuk kishte regjistruar në regjistrat përkatës pasuri të blera në vlerë prej 3,658€, të cilat, sipas natyrës së tyre, i takonin kategorisë së pasurive kapitale.
- Agjencia për Barazi Gjinore pasurinë në vlerë prej 6,752€ , e kishte regjistruar njëkohësisht në dy sisteme (në e-Pasuria dhe në SIMFK), ndonëse këto pasuri, sipas vlerës individuale (nën 1,000€), i takonin kategorisë së pasurive jo-kapitale dhe duhej të regjistroheshin vetëm në regjistrin përkatës për këtë kategori.

Vlenë të përmendet se ASK na ka ofruar dëshmi për regjistrimin e softwarit në regjistrin e pasurisë në vitin 2026, megjithatë kjo nuk reflekton në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme efektive në procesin e regjistrimit dhe klasifikimit të pasurive, si dhe i komunikimit jo të mjaftueshëm ndërmjet njësive përgjegjëse. Në rastin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, mosregjistrimi i softuerit ishte pasojë e faktit se zyrtari përgjegjës për menaxhimin e pasurive nuk kishte qenë në dijeni për pranimin e softuerit në fund të vitit, duke rezultuar në mosregjistrimin e tij në sistemin SIMFK. Ndërkaq, në rastin e Institutit të Kosovës për Krime Luftë, mosregjistrimi i pasurive ishte ndikuar edhe nga

mungesa e planifikimit të linjës buxhetore për investime kapitale, çka ka ndikuar në trajtimin jo adekuat të këtyre pasurive në regjistrat përkatës.

Ndikimi Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë të pasurive dhe raportimi jo i duhur i tyre pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nënvlerësim / mbivlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të drejtë të tyre në pasqyra financiare.

Rekomandimi B1 Sekretari i Përgjithshëm duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshme për të evituar nënvlerësimin e pasurive, si dhe të siguroj që çdo pasuri e blerë të jetë prezantuar saktë dhe në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

ZKM dhe ASK ka realizuar pagesë në vlerë 21,852€, për lëndë përmbartimore bazuar në Aktgjykimet e Gjykatës Themelore nga kategoria "Mallra dhe Sherbime". Sipas natyrës së tyre këto shpenzime i takojnë kategorisë „Paga dhe Meditje”.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte rezultat i planifikimit jo të duhur ekonomik. Po ashtu, ishte ndikuar nga ekzekutimi i pagesave përmes Thesarit sipas vendimeve të Gjykatës.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kategoritë joadekuate të shpenzimeve ndikojnë në raportimin financiar jo të drejtë, si dhe në mbivlerësimin /nënvlerësimin e kategorive të shpenzimeve.

Rekomandimi B2 Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e ASK-së duhet të sigurojnë që të gjitha shpenzimet të planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike të përcaktuara në planin kontabël, në përputhje me rregullat financiare, me qëllim që raportimi financiar të jetë i saktë dhe i besueshëm në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2025 ishte 4,856,883€, prej tyre ishin shpenzuar 2,992,306€. Ato kishin të bënin me furnizim për zyrë, pajisje nën 1000€, dhe mbi 1000€, dreka zyrtare, shërbime kontraktuese tjera etj.

Çështja B3 - Mos përdorimi i modulit të e-prokurimit për menaxhimin dhe monitorimin e kontratave

Gjetja

“Rregullorja 01/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 përcakton që vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet në sistem të prokurimit elektronik nga menaxherët e kontratës nëpërmjet të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve, gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave kornizë”.

Nga pesë rastet e testuara në katër raste nuk ishte përdorur moduli për menaxhimin e kontraktorëve, ndërsa tek asnjëra nuk ishte kryer monitorimi i vlerësimit të performancës së tyre në sistemin e e-prokurimit.

Kjo situatë ka rezultuar si pasojë e mungesës së njohurive të nevojshme të menaxherëve të kontratave për përdorimin e modulit të dedikuar si dhe për shkak të mungesës së mbikëqyrjes dhe mbështetjes së duhur nga ana e zyrës së prokurimit.

Ndikimi

Mungesa e vlerësimit të performancës së kontratës përmes sistemit të prokurimit elektronik, ndikon në menaxhimin jo efektiv dhe transparent të kontratave si dhe nuk ofron mundësi që menaxhmenti në kohë reale të marrë informata mbi performancën dhe realizimin e kontratës.

Rekomandimi B3

Sekretari i përgjithshëm duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave të bëjnë administrimin dhe implementimin e kontratave nëpërmjet modulit për menaxhim të kontratave në sistem të prokurimit elektronik për të siguruar vlerësim adekuat të performancës së kontraktuesve dhe informata mbi progresin e implementimit të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2025, ishte 63,579€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2026.

Çështja B4 - Vonesa në pagesën e obligimeve

Gjetja

Neni 39.1 i LMFPP përcakton që: ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Edhe pse krahasuar me vitet e mëparshme vlera e obligimeve të mbetura në fund të vitit ishte zvogëluar, nga mostrat e testuara u identifikua se në tre raste, në vlerë prej 6,420.91€, pagesat për faturat e pranuar nuk ishin realizuar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat në kryerjen e pagesave ishin nga 14 deri në 30 ditë.

Ndikimi

Tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund ta bëjë ZKM-në subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbarimore apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi B4

Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë periudhës aktuale të auditimit, e të cilat nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1

Mangësi gjatë përgaditjes të Pasqyrave Financiare

Gjetja

Në Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 të ZKM-së kemi identifikuar mos-pajtueshmëri në deklarime si në vijim:

1. Neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme (burimet dhe shfrytëzimi i fondeve) - nuk ishte shpalosur vlera e pranimeve tjera, po ashtu edhe tek " Shfytëzimi i fondeve-Pagesat" - nuk ishte shpalosur vlera e Pagesave tjera-Kthimi i Donacioneve.

2. Neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit:

- hyrjet e parasë së gatshme - Te hyrat tjera- nuk ishte shpalosur realizimi.

- hyrjet e parasë së gatshme - shuma e buxhetit fillestar dhe final për të hyrat jo-tatimore nuk ishte shpalosur.

- daljet e parasë së gatshme- Buxheti final- vlerat e shpalosura ishin të nënvlerësuara për të gjitha kategoritë.

Veprimi i kërkuar

ZKM-së i është kërkuar të bëjë korrigjimet e nevojshme në Pasqyrat Vjetore Financiare me qëllim të sigurimit të paraqitjes së saktë dhe të plotë të informacionit financiar.

Rezultati

ZKM ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe ka korrigjuar mos-pajtueshmëritë e identifikuara, në përputhje me kërkesat ligjore. Megjithatë, ZKM duhet të ketë në vëmendje forcimin e kontrolleve të brendshme në procesin e përgatitjes dhe rishikimit të raporteve financiare, me qëllim të parandalimit të përsëritjes së çështjeve të ngjashme në të ardhmen. Në rast të përsëritjes, çështja do të trajtohet si gjetje me rekomandim përkatës.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	21,308,710	13,813,398	11,505,030	18,757,533	9,462,714
Grante Qeveritare - Buxheti	20,535,085	12,445,092	11,328,358	18,411,390	8,639,180
Financimi përmes huamarrjes	773,625	773,625	0	0	0
Donacionet vendore	0	19,612	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	575,069	176,673	346,143	823,534

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 7,495,312€. Kjo ulje është rezultat i vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2025, ZKM kishte shpenzuar 83% të buxhetit përfundimtar ose 11,505,533€, me një rritje prej 3% në krahasim me vitin 2024.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	21,308,710	13,813,398	11,505,030	18,757,533	9,462,714
Pagat dhe mëditjet	5,314,025	4,985,660	4,603,287	4,061,360	3,765,146
Mallrat dhe shërbimet	6,050,772	4,773,332	2,959,415	9,295,877	3,981,589
Komunalitë	88,226	83,551	32,891	39,343	24,733
Subvencionet dhe transferet	7,805,687	3,410,490	3,400,062	5,278,070	1,353,532
Investimet Kapitale	2,050,000	560,366	509,375	82,882	337,714

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 328,365€, përmes vendimeve të Qeverisë dhe kursimeve buxhetore. Realizimi në këtë kategori ishte 92%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,277,440€, përmes vendimeve të Qeverisë dhe kursimeve buxhetore. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte vetëm 62% e buxhetit final.
- Buxheti final për komunalitet në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,675€. Realizimi në këtë kategori ishte 40%.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,395,197€. Realizimi në këtë kategori ishte 99%.
- Buxheti final për investime kapitale ishte zvogëluar për 1,489,634€ në raport me buxhetin fillestar, ndërsa realizimi në këtë kategori ishte 90%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



ZKM nuk realizon të hyra, vlera prej 4,100€ ka të bëjë me kthim nga subvencioni.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	10,000	10,000	4,100	2,582	1,435
Të hyrat jo tatimore	10,000	10,000		2,582	1,435
Të hyrat tjera	0	0	4,100		

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të ZKM-së ka rezultuar në 5 rekomandime kryesore. ZKM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, vetëm një rekomandim ishte zbatuar, ndërsa katër rekomandime janë përsëritur.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak





Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e ASK-së duhet të sigurojnë që të gjitha shpenzimet të planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike të përcaktuara në planin kontabël, në përputhje me rregullat financiare, me qëllim që raportimi financiar të jetë i saktë dhe i besueshëm në PVF.	Edhe këtë vit kemi hasur në raste të njejta.	Nuk ka filluar zbatimimi
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Sekretari i përgjithshëm duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave të bëjnë administrimin dhe implementimin e kontratave nëpërmjet modulit për menaxhim të kontratave në sistem të prokurimit elektronik për të siguruar vlerësim adekuat të performancës së kontaktuesëve dhe informata mbi progresin e implementimit të kontratës.	Edhe këtë vit kemi hasur në raste të njejta.	Nuk ka filluar zbatimimi
3.	Pasuritë	Sekretari i Përgjithshëm duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshme për të evituar nënvlerësimin e pasurive, si dhe të sigurojë që çdo pasuri e blerë të jetë prezantuar saktë dhe në PFV.	Agjencionet si ASK, dhe IKKL nuk kishin regjistruar në regjister të pasurisë blerje të bëra gjatë vitit 2025, kurse ABGj kishte regjistruar gabimisht blerjet e vitit në SIMFK..	Nuk ka filluar zbatimimi
4.	Obligimet e paguara	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.	Krahasuar me vitet e kaluara vlera e obligimeve të mbetura ishte dukshëm më e vogël megjithatë ende kishte vonesa pagesë e tyre.	Nuk ka filluar zbatimimi
5.	Detyrimet Kontigjente	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë të Statistikave të Kosovës (ASK) duhet të sigurojë që detyrimet kontigjente të prezantohen në vlera të sakta si dhe të mbahen evidenca të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.	ZKM nuk kishte detyrime kontigjente për vitin 2025.	Nuk është i aplikueshëm më

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Arta Kryeziu, Udhëheqëse e ekipit



Abdurrahmon Bërbatovci, Anëtar i ekipit



Leonora Hasani, Anëtare e ekipit



Hysen Restelica, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	Vendimi i Gjykatës në vlerë prej 4,990.00 është ekzekutuar nga Thesari në favor të një ish-konsulenti , i cili nuk ka qenë dhe nuk figuron në listat e pagave të Institucionit ASK. ZKA siguron që shpenzimet janë në përputhje me rregullat financiare të Thesarit, dhe kjo çështje mos të përfshihet në raportin përfundimtarë.	Gjetja dhe rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Letër konfirmim



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - General Secretary

Republika e Kosovës - Republic of Kosovo	
Zyra e Kryeministrit - Office of the Prime Minister	
SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Numri i Urdhrit / Order No. 02	No. Pjes. / Part No. 325/2
No. Hapës / No. pages - 2 -	Data / Datum / Date 29.04/2026
Prishtinë / Pristina	

Datë: 29.04.2026
Nr. prot: 067/2026

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem në përgjithësi me gjetjet dhe rekomandimet e Raportit, me përjashtim të Çështjes B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve për Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK), për të cilën ASK nuk pajtohet dhe ka paraqitur komente shtesë të bashkangjitura për shqyrtim;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

Arben Krasniqi
Sekretar i Përgjithshëm

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.